



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 40
Prishtinë, më 29 maj, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Mërgim Lushtaku, Avdullah Hoti, Emilija Rexhepi, Albert Kinolli, Ali Lajçi.

Munguan: Andin Hoti, Verica Ceraniq, Valon Ramadani dhe Faton Topalli.

Stafi mbështetës: Antigona Ibraj, Mehmet Simnica, Ajet Avdullahu dhe Aurel Haxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë: Besnik Osmani dhe Imri Semetishta.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë 24.5.2019;
3. Shqyrtimi i raportit të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, së bashku me PVF- të e audituara;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018;
5. Shqyrtimi dhe votimi i rekomandimeve për raportin e auditimit të raporteve vjetore financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2017;
6. Të ndryshme

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua nga deputetët e pranishëm.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.5.2019

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.05.2019, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, së bashku me PVF- të e audituara

Kryetari përshëndeti të pranishmit dhe tregoi se i ftuar në komision është auditori i përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit, z. Besnik Osmani, i cili do të prezantojë raportin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, së bashku me PVF- të e audituara dhe ia dha fjalën z. Besnik Osmani.

Besnik Osmani, tha se në bazë të nenit 138, paragrafit 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në bazë të Ligjit nr. 05/L-055, për auditorin e përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, auditori i përgjithshëm ka dorëzuar në Kuvend, raportin vjetor të performancës rreth aktiviteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Ky raport përfshin ekstraktet relevante nga pasqyrat vjetore financiare, pasqyrat vjetore financiare të Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2018, janë audituar nga operatori ekonomik për auditim të jashtëm “Audit grup” (i emëruar nga Kuvendi për një periudhë të auditimit prej tri vitesh). Sipas këtij auditimi, del se pasqyrat vjetore financiare të prezantuara të Zyrës Kombëtare të Auditimit, paraqesin një pamje të drejtë dhe reale. Po ashtu, në letër-menaxhmentin e përgatitur nga kompania audituese e angazhuar nga Kuvendi i Kosovës, ku flitet për rekomandimet e viteve paraprake dhe progresin e arritur deri në auditimin e PVF-së të vitit 2018. Bazuar në raportin vjetor të performancës të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, shihet se është bërë një progres në rritjen e numrit të auditimeve të rregullsisë, në trefishimin e auditimeve të performancës dhe me trefishimin e auditimit të ndërmarrjeve publike. Gjatë vitit 2017, Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë mbi 1.000 rekomandime për entitete të audituara. Institucionet e pavarura prijnë për nga numri i rekomandimeve të zbatuara, megjithatë progresi i përgjithshëm nuk është ende i kënaqshëm. Raporti i performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, është i hartuar sipas kornizës së matjes së performancës për 25 tregues, të ndarë në 6 fusha: 1. Pavarësia dhe korniza ligjore; 2. Qeverisja e brendshme dhe etika; 3. Mbulimi i auditimit dhe raportimi; 4. Menaxhimi financiar, pasuritë dhe shërbimet mbështetëse; 5. Burimet njerëzore dhe trajnimet; 6. Komunikimi dhe bashkëpunimi me palët e interesit.

Sa i përket auditimeve të planifikuara dhe të realizuara deri në fund të vitit 2018, ZKA-ja ka përfunduar dhe publikuar 122 raporte, prej tyre 109 raporte të auditimit të rregullsisë, 13 raporte të auditimit të performancës. Nga ky numër i auditimeve, ZKA-ja ka arritur të nxjerrë 1.177 rekomandime, prej tyre 307 rekomandime për nivelin qendror, 220 rekomandime për institucionet e pavarura dhe 650 rekomandime për komunat. Nga ky numër i rekomandimeve të dhëna, janë zbatuar vetëm 395 rekomandime apo 33% e tyre. Ndërsa, të paadresuara ishin 471 rekomandime apo 40% e rekomandimeve të dhëna.

Gjatë vitit 2018, ZKA-ja ka realizuar këto auditime të performancës:

- menaxhimi i marrëveshjeve të bashkëfinancimit me donatorët dhe rezultatet e arritura;
- efektiviteti i sistemit informativ të tatimit në pronë;
- menaxhimi dhe shfrytëzimi i aplikacionit e-Pasuria;
- mekanizmat institucionalë për rregullimin ligjor, monitorimin dhe raportimin e cilësisë së ajrit;
- vlera për para në prokurime të centralizuara;
- efikasiteti dhe efektiviteti i politikave të punësimit;
- menaxhimi financiar dhe kontrollet e borxheve publike për periudhën 2009-2017;
- tregues performance për nivelin qeverisës lokal, për vitin 2017;
- efektiviteti i programeve të veçanta të banimit;
- menaxhimi i të hyrave vetjake në nivelin lokal;
- vlerësimi i sistemeve të Teknologjisë Informative në nivelin qendror dhe atë lokal;
- menaxhimi i listës esenciale të barnave; dhe,
- zbatimi i rekomandimeve për pajisjet mjekësore, rasti “Tomografia e kompjuterizuar”.

Te menaxhimi financiar i ZKA-së, buxheti i ZKA-së për vitin 2018, krahasuar me vitin 2017, është 15% më i lartë. ZKA-ja është duke u përkrahur edhe nga Banka Botërore, në projekte, në shumën prej 164,930 eurosh, projekt ky që pritet të përfundojë në shtator të vitit 2019. Shpenzimet më të mëdha të buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të ZKA-së, për vitin 2018, janë shpenzuar për pagesën e qirasë dhe atë në 28%. Ndërsa, pjesëmarrja e shpenzimeve në buxhetin e përgjithshëm të ZKA-së në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 24%.

ZKA-ja, gjatë vitit 2018, me Ligjin e buxhetit ka miratuar 167 pozita, prej të cilave janë plotësuar 165. Struktura e të punësuarve në Zyrën Kombëtare, është 51% femra, moshë mesatare 40.4 vjeçare dhe nga komunitetet janë 4 persona. Në pozita udhëheqëse janë 32 femra apo shprehur në përqindje, 44% e të punësuarve në pozita menaxheriale.

Nga 165 të punësuar, 27 prej tyre janë punonjës të shërbimit civil dhe staf mbështetës. ZKA-ja, gjatë vitit 2018, ka rekrutuar 9 veta, si staf të ri, ndërsa punën e kanë lëshuar 3 të punësuar, rrjedhimisht numri i të punësuarve në ZKA është rritur për 6. Për të mbështetur këto ndryshime janë zhvilluar 10 procese të rekrutimit.

ZKA-ja ka prezantuar në mënyrë të detajuar të arriturat dhe sfidat që ka pasur gjatë vitit 2018, prandaj bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, që ZKA-ja është kategori kushtetuese dhe në Ligjin për menaxhim të financave publike, që ZKA-në e kategorizon si agjenci të pavarur, e cila i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe bazuar në Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Rregulloren e Punës së Komisionit, raporti performancës i Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018, është sipas standardeve të kërkuara, prandaj ftoj deputetët ta përkrahin raportin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2018.

Kryetari tha se veçse u përmenden procedurat e prokurimit, ku mund të lidhet me çështjen e prokurimit elektronik, ku ka disa të gjetura ku 5 nga 10 raste njoftimi mbi dhënien e kontratës nuk është përgatitur brenda 2 ditëve, pas dhënies së kontratës siç kërkohet të neni 41, në 4 nga 10 raste kontratat janë nënshkruar para kalimit të afatit 10 ditorë, në 2 nga 10 raste datat e caktuara të nënshkrimit të kontratës në dokumentin e njoftimit për nënshkrimin e kontratës dallonte nga data e nënshkrimit të kontratës. Lidhur me këtë, kërkoi që t'i kushtohet më shumë vëmendje dhe rëndësi, sa i përket prokurimit.

Ali Lajci, tha se kemi propozuar për ndarjen e buxhetit për shfrytëzimet e objekteve, lokalet me qira për nivel të përgjithshëm, që ushtrojnë veprimtari edhe ministritë e tjera në një buxhet rreth 8 milionë. Po ashtu, përmendi se kanë propozuar listën e objekteve që menaxhon Qeveria dhe janë nën pronësinë e saj që të shikohet dhe kush i ka objektet e shtetit me qira e që shfrytëzohen në forma informale, kurse në marrim me qira lokale, objekte të ndryshme dhe ushtrojmë veprimtari të tjera dhe kështu buxheti ngarkohet me këto pagesa. Prandaj, do duhej të kemi një listë të Qeverisë, e cila disponon objektet e saj, si e menaxhon dhe kush, ku është i vendosur, kështu që pagesa e qirasë të destinohet diku tjetër.

Emilia Rexhepi, fillimisht përgëzoi z. Osmani për punën profesionale që po bën kjo zyrë dhe deshi të lidhet me raportin, te pjesa e burimeve njerëzore, ku i përgëzoi për barazinë gjinore ku ZKA ka numër të madh të femrave të punësuar, mirëpo ende mbetet mungesë punësimi i minoriteteve, numri nuk ka ndryshuar nga vitet e kaluara e që ende janë vetëm 4 të punësuar dhe dëshiron ta di se a është ndonjë nga ta, pra nga komuniteti boshnjak. ZKA ka të planifikuara tash e sa vite disa pozita për komunitetet e tjera, cila është strategjia e juaj për punësimin e komuniteteve?

Besnik Osmani, sa i përket komuniteteve, tha se ZKA ka 4, që janë nga ai serb dhe janë të punësuar nga procedurat e rregulla që nga viti 2007. Po ashtu, theksoi se ZKA dëshiron të rrisë numrin e tyre, pasi që përdorimi i gjuhës në disa komuna do ndihmonte shumë ZKA-në dhe çdoherë që do ketë auditorë nga minoritetet që plotësojnë kushtet ligjore, janë të gatshëm që t'i punësojnë. Ai shtoi se ZKA gjithmonë mbajnë dy vende të rezervuara për komunitetet e tjera dhe në çdo rast që do të ketë auditorë të certifikuar nga minoritetet, do të jetë i gatshëm për rekrutimin e tyre.

Avdullah Hoti përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi për punën e z. Osmanit. Më tej, theksoi se dëshiron të ngre pesë çështje. Auditimet e performancës duhet të rriten më shumë dhe kur po bëhen, nuk po definojnë qartë se çka nënkupton performancë e mirë në institucionin që ZKA e auditon. Pra, ka nevojë që auditorët e ZKA-së të përgatiten më mirë, që të kryejnë në të ardhmen më shumë auditime të performancës. Tek adresimi i rekomandimeve, z. Hoti tha se me kalimin e viteve është rritur numri i rekomandimeve të paadresuara fare nga institucionet dhe pyeti se çka e ka shkaktuar. Tek auditimi i ndërmarrjeve publike, tha se është shumë mirë që ZKA ka filluar ta bëjë këtë auditim. Problemi qëndron se në këto auditime, ZKA duhet t'i japë komisionit një vlerësim të rolit të aksionarit, të cilin rol aksionari nuk është duke e luajtur fare në 2 vitet e fundit. Gjithashtu, shtoi se është përkeqësuar pozicioni ligjor i auditorëve përmes Ligjit të zyrtarëve publikë, se ata tani trajtohen si çdo shërbyes civil. Më tej, z. Hoti tha se duhet të bëjmë më shumë kërkesa karshi ZKA-së për auditime të caktuara, sipas kërkesës dhe tha se i vjen mirë që KMFP ka krijuar një bashkëpunim të mirë me Zyrën Kombëtare të Auditimit.

Besnik Osmani, tha se auditimet e performancës në 2016 kanë qenë 0. Për auditimet e performancës sfidohen shtetet më të zhvilluara në botë, për shkak se auditorët duhet të kenë shumë njohuri të gjëra në fushat e politikave publike dhe ekonomisë. Megjithatë, ai theksoi se ZKA ka arritur që të ketë një program të kombinuar, ku auditorët bëjnë auditime në fushën e performancës, por krahas tyre rrisin kapacitetet përmes trajnimeve të caktuara. Që nga miratimi i Ligjit për zyrtarët publikë, janë larguar 4 punëtorë nga ZKA. Pra, unë nuk mund t'i mbaj auditorët me këto paga, me të cilat auditorët janë dëmtuar pas miratimit të ligjit. Secili auditor i certifikuar i ZKA-së, në cilindo sektor privat, qoftë për projekt, program, mund të marrin dyfishin e pagës që e kanë në ZKA. Statusi juridik na e ka dëmtuar statusin. Po e marr këtu një shembull, kemi aplikuar për anëtarësim në Intosai, në fazën finale na ka ardhur Ligji për shërbyesit publikë dhe ata janë të prekur shumë në pavarësinë e institucioneve supreme të auditimit, dhe pa dashur të hyj politikë, nëse e ka dëgjuar dikush dje, që Serbia në deklaratën e kryetarit të Serbisë, që ata e konsiderojnë sukses të tyre shtyrjen e votimit për ne, për anëtarësim në Intosai, por kjo nuk është sukses i tyre, por është dështim i Kuvendit të Kosovës me miratimin e Ligjit për shërbimin publik, ashtu siç është miratuar. Unë, para miratimit të këtij ligji, kam takuar të gjitha grupet në Kuvendin e Kosovës dhe ua kam sqaruar situatën, por prapë jemi këtu ku jemi.

Sa i përket auditimeve të performancës, ka kërkuar nga auditorët që çdo 6 muaj auditorët të dalin me nga një auditim të performancës. ZKA ka kërkuar që Kuvendi t'i ndihmojë të kenë disa lehtësira në përdorimin e buxhetit për angazhimin e disa ekspertëve, kur ata i duhen ZKA-së. Sa i përket rekomandimeve, numri i rekomandimeve të pazbatuara është rritur siç është rritur numri i rekomandimeve plotësisht të zbatuara, por ka rënë numri i rekomandimeve pjesërisht të zbatuara, ose kanë punuar në zbatimin e plotë të rekomandimit, ose nuk e kanë prekur fare. Me raportin e këtij viti, tha se për pasqyrat e shtetit do të ketë edhe një kapitull të veçantë për mosadresimin e 40% për vitin e kaluar. Për ndërmarrjet publike, tha se kanë potencuar që aksionari ka për obligim të bëjë një vlerësim të performancës së bordit, i cili është një obligim ligjor dhe këtë e gjeni në raportet e ZKA-së. Më tej, theksoi se në raporte kanë shkruar të gjeturat, për të cilat mendojnë se janë kompetenca të bordit dhe bordi ka dështuar për t'i zbatuar. Nga 43 rekomandime, 24 i drejtohen bordit, që do thotë se aksionari nuk ka qenë efektiv që të kryejë pjesën e vet për ndërmarrje. Sa i përket kërkesave prej Kuvendit, ZKA është munduar që t'i trajtojë kërkesat, edhe pse jo të gjitha, kanë marrë 4 kërkesa nga Kuvendi, tri janë zbatuar dhe një jo; auditimi i telekomit, auditimi i postës, auditimi në bujqësi, por nuk ka qenë e mundur të kryhet auditimi i privatizimit të KEDS-it.

Kryetari theksoi se raporti i Kuvendit me ZKA-në duket se ka shkuar në përkeqësim. Ligji i pagave, statuti për shërbimin publik është problem serioz. Në mbledhjet e tjera të komisionit do të shohin se a mund të kërkojnë plotësim-ndryshime më të shpejta për Ligjin për shërbim publik, Ligjin për paga, që mos të rrezikohet puna e ZKA-së. Më tej, pyeti: Cila është përgjigja e Kuvendit me kërkesën e juaj për ekspertë? A po paraqet problem për të realizuar aktivitetet e ZKA-së, 28%-shi i shpenzuar për qira

nga mallra dhe shërbime? Gjithashtu shtoi se siç shihet, fokusi i ZKA-së për 2019 është forcimi i pavarësisë, zhvillimi i kapaciteteve dhe komunikimi dhe integrimi, por tha se nuk po sheh se është në fokus rritja e numrit të auditimeve të ndërmarrjeve publike, auditimeve të performancës. Pse?

Besnik Osmani, tha se ZKA ka planin strategjik 3 vjeçar, në bashkëpunim me KMFP-në, pra rreth 20% me 80% është raporti me auditimet e performancës dhe auditime të tjera. Me planin strategjik 3 vjeçar, me ndryshimet që janë bërë këtë vit, pas 3 vjetëve, ZKA synon që të jetë 50% me 50% dhe duhet të plotësohen 2 kushte, ndryshimi i Ligjit për ZKA-në, që të mos jetë obligues auditimi për disa nga institucionet e vogla dhe me rrezik në auditim dhe të rrisin kapacitetet e auditorëve të performancës. Te çështja e ekspertëve, Ligji për shërbyesit publikë, që dërgon ZKA-në te Qeveria, që nga identifikimi se çfarë profili i duhet që Qeveria ta miratojë, pastaj shpallja dhe procedurat e tjera e bëjnë të pamundshëm rekrutimin e ekspertëve. Kuvendi mund të ndihmojë ZKA-në, përmes ndryshimit të Ligjit për auditorin e përgjithshëm.

Kryetari falënderoi z. Osmanin për informatat dhe punën që ZKA bën. Më pas, theksoi do të shohim për plotësim-ndryshim të ligjeve, që mos të rrezikohet puna juaj dhe të vazhdojë puna për anëtarësim në organizata ndërkombëtare.

Përfundim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi raportin e performancës së Zyrës Kombëtare të Auditimit, për vitin 2018, së bashku me PVF- të e audituara dhe të njëjtin i rekomandon seancës plenare për miratim.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për PVF-të e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018

Kjo pikë e rendit të ditës nuk është shqyrtuar, për shkak se ministri Rasim Demiri nuk ka qenë prezent.

5. Shqyrtimi dhe votimi i rekomandimeve për raportin e auditimit të raporteve vjetore financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2017

Kryetari prezantoi rekomandimet e përgatitura nga stafi:

1. Për Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA)

1. ZKA-ja, me rastin e auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të ketë një fokus më të theksuar në Programin për Demokratizim dhe Mbështetje të Subjekteve Politike, përkatësisht për shumën e mjeteve që KQZ-ja ndan nga granti, në emër të grupeve parlamentare të subjekteve politike.

I. Për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

1. KQZ-ja ta funksionalizojë Zyrën për Regjistrim të Subjekteve Politike, duke e plotësuar me staf profesional, në mënyrë që të jetë në gjendje t'i pranojë raportet sipas standardit të raportimit financiar të zbatuar në Kosovë, si dhe sipas modelit të raportimit financiar të hartuar nga vetë KQZ-ja, për të bërë një kontroll adekuat të dokumentacionit të raporteve të pranuar.

2. KQZ-ja t'i obligojë subjektet politike, të dorëzojnë raportet financiare vjetore dhe të fushatës, në emër të subjektit politik apo koalicionit, me të cilin emër është certifikuar subjekti politik.

3. KQZ-ja, me rastin e prezantimit të pasqyrave vjetore financiare, duhet të shpalosë në mënyrë më të detajuar alokimet dhe shpenzimet, si për subjektin politik, po ashtu edhe në emër të grupit parlamentar, në mënyrë që të kemi një transparencë dhe llogaridhënie më të mirë.

II. Rekomandim për subjektet politike

4. Subjektet politike t'i respektojnë kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës, sipas Ligjit nr. 04/L-212 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-174 për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe të plotësuar me Ligjin nr. 04/L-058.

5. Subjektet politike të angazhojnë zyrtarë financiarë adekuatë, në mënyrë që të hartohen drejt dhe saktë raportet financiare, sipas standardeve të kërkuara me legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë.

6. Subjektet politike, brenda strukturës organizative, do të duhej të kenë një person, i cili kryen funksionin e auditorit të brendshëm, i cili do të ndihmojë në përmirësimin e kontrollit të brendshëm financiar të partive politike.

Përfundim

Rekomandimet e përgatitura nga stafi për raportin e auditimit të raporteve vjetore financiare dhe atyre të deklarimit financiar të fushatës së subjekteve politike për vitin 2017, u votuan me disa ndryshime dhe do t'iu adresohen institucioneve përgjegjëse.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj